VENDIM
Nr. 452, datë 27.5.2015

PËR NGRITJEN E VARREZAVE PRIVATE NË NJËSINË ADMINISTRATIVE "PASKUQAN", QARKU TIRANË

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 3/b, të ligjit nr. 9220, datë 15.4.2004, "Për shërbimin publik të varrezave", të ndryshuar, dhe të nenit 15, të ligjit nr. 8743, datë 22.2.2001, "Për pronat e paluajtshme të shtetit", me propozimin e ministrit të Zhvillimit Urban, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e ngritjes së varrezës private, në territorin e njësisë administrative "Paskuqan", Qarku Tiranë, sipas propozimit të paraqitur nga subjekti privat "VEBO Invest", sh.p.k., depozituar pranë Ministrisë së Zhvillimit Urban.

2. Autorizohet Ministria e Zhvillimit Urban për negocimin dhe lidhjen e aktmarrëveshjes me subjektin privat "VEBO Invest", sh.p.k., për përcaktimin e rregullave të funksionimit dhe administrimit të kësaj varreze private.

3. Pasuria nr. 1378, me sipërfaqe 881 375 (tetëqind e tetëdhjetë e një mijë e treqind e shtatëdhjetë e pesë) m^2, e ndodhur në zonën kadastrale nr. 8284, në pronësi shtet, i kalon në përgjegjësi administrimi Ministrisë së Zhvillimit Urban. Ministria e Zhvillimit Urban, nga momenti i nënshkrimit të aktmarrëveshjes, sipas pikës 2, të këtij vendimi, të kryejë kalimin në përdorim të subjektit privat "VEBO Invest", sh.p.k. të truallit.

4. Ministrisë së Zhvillimit Urban i ndalohet të ndryshojë destinacionin e pronës që i kalon në përgjegjësi administrimi.

5. Ministria e Zhvillimit Urban të zbatojë dispozitat e ligjit nr. 9220, datë 15.4.2004, "Për shërbimin publik të varrezave", të ndryshuar, dhe akteve nënligjore në zbatim të tij, për lidhjen e aktmarrëveshjes.

6. Agjencia Kombëtare e Planifikimit të Territorit të paraqesë harmonizimin e projektit të ndërtimit të varrezës private me planet zhvillimore në fuqi ose në proces dhe të plotësojë, pas lidhjes së aktmarrëveshjes midis palëve, dokumentacionin për leje zhvillimore, në bazë të projektit të subjektit kërkues, të cilat do të miratohen në Këshillin Kombëtar të Territorit.

7. Ngarkohen Ministria e Zhvillimit Urban, Agjencia Kombëtare e Planifikimit të Territorit, kryeregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë dhe Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Tiranë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama